



**MONITORIMI I PLANIT TË VEPRIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E
STRATEGJISË SË KOMUNIKIMIT TË KLSH-SË PËR PERIUDHËN**

1 KORRIK - 31 DHJETOR 2018

Nr.	Objektivi	Personi/personat përgjegjës	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Shënime/Statusi i Implementimit
1	Rritja e profilit publik të KLSH-së dhe e të kuptuarit të misionit, vizionit dhe rolit të tij në shoqëri, për të forcuar besimin e qytetarëve tek institucioni				
1.1	Prodhimin dhe shpërndarjen e fletë-palosjeve, broshurave me mesazhet kryesore të auditimeve dhe të propozimeve të KLSH për përmirësimin e administrimit të Buxhetit të Shtetit.	Irena Islami Elisa Metaj Departamentet e Auditimit	Maj-qershor 2018,2019 dhe Çdo vit pas botimit të librit të Performancës së institucionit në gjuhën shqipe dhe angleze.	Buxheti i Shtetit	Ne zbatim të kontratës së botimeve, KLSH prodhon për çdo botim një fletëpalosje dhe 2 katalogë ku përmbledhen materialet e botimeve. Shpërndarë në aktivitetet e panairëve. Publikimi i Raportit te Performancës në faqen e uebit (realizuar)
1.2	Përcjelljen më fort dhe qartë të mesazheve kryesore të auditimeve të performancës dhe të propozimeve të KLSH për përmirësimin e administrimit të Buxhetit të Shtetit në mediat tradicionale, në gazetat dhe revistat kryesore, nëpërmjet shkrimeve të audituesve të KLSH, si dhe kontributeve nga	Të gjithë audituesit e Departamentit të Auditimit të Performancës dhe bashkëpunëtorët e KLSH-së	Në vijimësi		Botime artikujsh të audituesve dhe njoftime për shtyp. Dalja e Drejtorit të Departamentit dhe audituesve të këtij Dep. në disa media vizive. Botimi “Audituesit e KLSH-së në Shtypin e Përditshëm”, volumi IX, X, XI, çdo 6 muaj

Nr.	Objektivi	Personi/personat përgjegjës	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Shënime/Statusi i Implementimit
	analistë dhe gazetarë të njohur, partnerë të KLSH.				(realizuar)
1.3	Afrimin më shumë të audituesve të talentuar për shkrime dhe të vetë gazetarëve dhe analistëve pranë departamenteve të auditimit, për kuptimin prej tyre të mesazheve qendrore të auditimeve dhe përcjelljen e tyre në publik nëpërmjet një gjuhe të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë për qytetarin.	Të gjithë audituesit e rinj të KLSH-së; Amantja Patozi	Në vijimësi		<p>Gjatë muajit të hapur të organizuar në KLSH gjatë muajit nëntor dhe dhjetor 2018, auditues të rinj nga departamentet e auditimit referuan eksperiencën e tyre për fazat e ndryshme të procesit të auditimit në prani të gazetarëve dhe përfaqësuesve të OJF-ve.</p> <p>Botimi “Audituesit e KLSH-së në Shtypin e Përditshëm”, volumni IX, X, XI, çdo 6 muaj</p> <p>(realizuar)</p>
1.4	Organizimi i Muajit të hapur për qytetarët	Drejt.Komunik; Dep.Auditimit	Nëntor 2017; Nëntor 2018; Nëntor 2019		<p>Muaji i hapur për vitin 2018 u realizua në periudhën 25 tetor-14 dhjetor 2018</p> <p>(realizuar)</p>

Nr.	Objektivi	Personi/personat përgjegjës	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Shënime/Statusi i Implementimit
1.5	Organizimi i Ditës së Performancës Publike të Shtetit Shqiptar, për të dhënë fort mesazhet kryesore të KLSH, sidomos në fushën e këshillimit.	Departamentet e Auditimit; Drejtoria e Komunikimit	Nëntor të 2018 dhe 2019, gjatë muajit të hapur të KLSH-së		<p>Aktivitet i zhvilluar gjatë Muajit të hapur.</p> <p>Departamenti i Auditimit të Performancës dhe Drejtoria e Komunikimit dhe Marrëdhëniet me Jashtë.</p> <p style="text-align: right;">(realizuar)</p>
1.6	Organizimi i Konferencave Vjetore Shkencore të KLSH-së	Kryetari; Drejt.Komunikimit	Tetor 2017; Prill 2018 (Kuvajt); Dhjetor 2018; Pranverë 2019		<p>Në datat 09-11.04.2018, në qytetin e Kuvajtit, zhvilloi punimet Konferenca Shkencore e përbashkët mes KLSH dhe Byrosë së Auditimit Shtetëror të Kuvajtit me temë “Auditimi me bazë risku”.</p> <p>14 Dhjetor 2018 u realizua Konferenca Kombëtare KLSH dhe IDM, me temë “Për një autoritet Kombëtar Anti-korrupsion të gjithëpranuar dhe mirëvendosur në sistemin e qeverisjes”.</p> <p style="text-align: right;">(realizuar pjesërisht)</p>
1.7	Organizimi i Analizave vjetore të punës së Departamenteve dhe të institucionit, të cilat do të jenë të hapura për mediat dhe për qytetarët.	Të gjitha strukturat e KLSH-së.	Shkurt 2018; Shkurt 2019		<p>Analiza vjetore 2017 realizuar në Shkurt 2018.</p> <p>Planifikuar për t’u realizuar analiza vjetore 2018 (shkurt 2019).</p> <p style="text-align: right;">(realizuar)</p>

Nr.	Objektivi	Personi/personat përgjegjës	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Shënime/Statusi i Implementimit
1.8	Pjesëmarrja KLSH-së me kolanën e botimeve të saj ne Panairin e Librit	Drejtoria e Komunikimit	Nëntor 2017, 2018, 2019		Realizuar Nëntor 2017 dhe nëntor 2018 në panairin Klik Exspo Group, në të cilin KLSH u paraqit me 95 botime. (realizuar)
2	Shtimi i mjeteve të komunikimit të jashtëm të KLSH-së me qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit me qëllim rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut				
2.1	Caktimin e një koordinatori për marrëdhëniet me publikun dhe qytetarin pranë çdo departamenti auditimi;	Amantja Patozi	Brenda muajit dhjetor 2017		Janë caktuar koordinatorët për marrëdhëniet me publikun dhe qytetarët në departamentet e auditimit dhe drejtoritë mbështetëse. (realizuar)
2.2	Hapjen dhe mirëmbajtjen e një faqeje në rrjetet sociale (Facebook, Instagram, Twitter, etj.) për institucionin;	Elisa Metaj; Aldo Kita; Elsona Papadhima; Koordinatorët e Dep.të Auditimit	Janar 2019		Në proces
2.3	Ristrukturimin dhe përditësimin e Portalit të KLSH www.klsh.org.al , duke vendosur dritare të reja të komunikimit interaktiv dhe të drejtpërdrejtë me	Kozma Kondakciu; Elisa Metaj; Sektori IT; Departamentet e Auditimit.	Në vijimësi		Përditësimi i Web-it me të dhëna. Vendosja e dritareve për komunikimin me qytetarin, etj.

Nr.	Objektivi	Personi/personat përgjegjës	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Shënime/Statusi i Implementimit
	qytetarin, të tipit “Shërbimet publike dhe TI (qytetari)”, “Qeverisja vendore dhe TI”, etj.				(realizuar)
2.4	Publikimin elektronik të buletinit tre mujor “Të bashkuar kundër mashtrimit financiar dhe korrupsionit” në shqip dhe anglisht, në bashkëpunim me përfaqësues të shoqërisë civile, etj.	Elisa Metaj; Dep. e Auditimit	Mars 2019		Në diskutime për këtë çështje
2.5	Organizim i leksioneve të hapura me studentë të Universiteteve të ndryshme të vendit me qëllim njohjen e tyre me misionin dhe rolin e institucionit.	Departamenti i Performancës; Drejtuesit e KLSH-së.	Pranverë 2018; Në vijimësi		Realizuar gjatë gjithë vitit, veçanërisht gjatë analizës vjetore dhe muajit të hapur, zhvilluar gjatë muajve nëntor – dhjetor 2018. (realizuar)
3	Promovimi i rezultateve të auditimit të KLSH për të transmetuar tek opinioni publik rezultatet dhe dobitë e institucionit në përmirësimin e qeverisjes, përmes luftës kundër korrupsionit				

Nr.	Objektivi	Personi/personat përgjegjës	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Shënime/Statusi i Implementimit
3.1	Caktimin e një grupi drejtuesish të KLSH si “përcjellës të autorizuar” të mesazhit të institucionit në publik, të aftë dhe të mandatuar të përfaqësojnë institucionin në emisione televizive apo radiofonike ku diskutohen tema kyçe të shërbimeve publike, menaxhimit financiar publik, qeverisjes vendore, etj.	Drejtoret e Përgjithshëm; Sekretari i Përgjithshëm; Drejt. e Dep. të Auditimit.	Në vijimësi		<p>Realizuar në pranverë 2018.</p> <p>Drejtori i Përgjithshëm intervista në RTSH;</p> <p>Drejtore i Departamentit të Auditimit të Performancës në Top Channel.</p>
3.2	Nënshkrimi i Memorandumit të mirëkuptimit me USAID për Projektin “Transparenca në sistemin shëndetësor në Shqipëri”.	Drejtorja e Komunikimit; USAID	Tetor 2017		<p>Nënshkruar marrëveshja me USAID-in në datën 3 Tetor 2017.</p> <p>(realizuar)</p>
3.3	Organizimi i një trajnimi të përbashkët, në kuadër të projektit të pikës 3.2 me përfaqësues të Institutit Shqiptar të Shkencës me temë “Përdorimi i të dhënave	Drejtorja e Komunikimit; Auditues të KLSH-së; Përfaqësues të Insitutit Shqiptar të Shkencës (Open	Gjashtë mujori i parë i vitit 2018		<p>Në datën 29-30 mars 2018, auditues të KLSH-së morën pjesë në trajnimin “Përdorimi i të dhënave dhe Algoritmi i Flamujve të kuq Instrumente për Transparencë dhe Anti-Korrupsion”. Dy trajnime të tjera me ISH të Shkencës janë realizuar gjatë muajit të hapur.</p>

Nr.	Objektivi	Personi/personat përgjegjës	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Shënime/Statusi i Implementimit
	dhe algoritmi i Flamujve të kuq, Instrumente për Transparencë dhe Anti-korrupsion”.	Data)			(realizuar)
3.4	Organizimi i një trajnimi të përbashkët, në kuadër të projektit të pikës 3.2 me përfaqësues të OJF që punojnë në fushën e shëndetësisë.	Drejtorja e Komunikimit; Përfaqësues të projektit; Auditues të KLSH-së;	Tre mujori i parë i vitit 2018		Gjatë 3 mujorit të parë të 2018 dhe 3 mujorit të tretë të vitit 2018 (realizuar)
3.5	Dhënie e kontributit të gazetarëve dhe analistëve të njohur, të partnerëve nga shoqëria civile, për tema të caktuara ose “kryemesazhe” të institucionit (si p.sh. ligji për përgjegjësinë materiale të nëpunësit publik, etj.), në formën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në përgatitjen e mesazhit ose nëpërmjet takimeve me grupe të interesit, me anë të opinionëve, editorialeve, ëorkshop-eve, prononcimeve në emisione të ndryshme.	Drejtorja e Komunikimit; Bashkëpunëtorët e KLSH-se dhe OJF-të që KLSH ka marrëveshje	Në vijimësi		Konferenca Kombetare organizuar nga KLSH dhe IDM, në datën 14 dhjetor 2018, “Për një autoritet Kombëtar Anti korrupsion të gjithëpranuar dhe mirëvendosur në sistemin e qeverisjes” Raporti i Auditimit të Performancës me temë “Strategjia Antikorrupsion e Qeverisë Shqiptare” (pjesërisht)

Nr.	Objektivi	Personi/personat përgjegjës	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Shënime/Statusi i Implementimit
4	Shtimi i komunikimit dhe ndërveprimit të KLSH-së me qytetarin, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në aktivitetet dhe tryezat e rrumbullakëta				
4.1	Qytetarët duhet të përfshihen gjithnjë e më shumë në çështjet e auditimit. Ata mund të ofrojnë indicie apo opinione për një sërë çështjesh apo fushash problematike.	Drejtoria e Komunikimit; Departamentet e Auditimit	Në vijimësi		Në faqen e ueb-it janë shtuar në menunë Kontakt--- Moduli i Ankesave Nyja --- Lidhje ---- Lidhje të vlefshme--- KLSH Media (realizuar)
5	Konsolidimi i pjesëmarrjes së audituesve në opinion-dhënien në median e shkruar dhe kalimi gradual drejt dhënies së opinionit në emisionet televizive				
5.1	Koordinatorët e marrëdhënieve me publikun dhe qytetarin pranë secilit departament auditimi do të kenë detyrën e raportimit për prurjet në median e shkruar të audituesve të departamentit, si dhe një plan(aty ku është e mundur) për temat që	Koordinatorët e Departam. të Auditimit; Drejtoria e Komunikimit; Dep.Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit.	Në vijimësi		Koordinatorët e përcaktuar nga Drejtorët e Departamenteve të Auditimit trajtojnë letrat e qytetarëve (ankesat) dhe përgatisin Raportet dhe Vendimet e Auditimeve për web. Gjithashtu auditues të përfshirë në auditime me tema të rëndësishme përgatisin njoftimet për shtyp. (realizuar dhe në vijimësi)

Nr.	Objektivi	Personi/personat përgjegjës	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Shënime/Statusi i Implementimit
	<p>audituesit e departament. mendojnë të trajtojnë në periudhën e ardhshme. Për audituesit do të organizohen dhe koordinatorët do të organizohen trajnime lidhur me mënyrën e përcjelljes së rezultateve të auditimit në media.</p>				
5.2	<p>Bashkëpunim i qëndrueshëm njëvjeçar për vitin 2018, me një televizion kombëtar ose shumë të shikuar, për bashkë-organizimin e një emisioni mujor Televiziv “Auditimi publik, qeverisja dhe qytetari” ose përfshirja në një emision ekzistues që trajton tema të fushës së ekonomisë. KLSH do të tregojë kujdesin e duhur për të ruajtur raportet e</p>	<p>Sekretari i Përgjithshëm; Drejtorët e Përgjithshëm; Drejtoria e Komunikimit.</p>	<p>Në vijimësi</p>		<p>(Pa realizuar)</p>

Nr.	Objektivi	Personi/personat përgjegjës	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Shënime/Statusi i Implementimit
	duhura me subjektet e audituara (ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, etj).				
6	Rritja e komunikimit të brendshëm në institucion dhe e shkëmbimit të informacionit mes drejtorive dhe departamenteve të auditimit				
6.1	Strategjia e Komunikimit 2017 - 2019 parashikon një mbështetje të fortë në përdorimin e internetit, mediave sociale duke përdorur shpesh, intensivisht dhe në mënyrë të përsëritur faqen e KLSH në internet, hapjen e një llogarie në rrjetet sociale si facebook, etj.	Kozma Kondakciu; Elisa Metaj; Sektori IT; Departamentet e Auditimit			Përditësimi i faqes zyrtare të KLSH. Ne faze punimi media sociale. (pjesërisht)